
POSTIM ARKIVOR

Sindikatat e pavarura në zhvillimet politike të vitit 1991



SEKSIONI

1970-1991

PERIUDHA

1991 - 1991

Viti 1991 shënoi vazhdimin e përplasjeve popullore dhe ndryshimeve historike që nisën që në vitin 1990 në Shqipërinë që po dilte nga regjimi komunist, ende nën drejtimin e Partisë së Punës. Vendi po kalonte një krizë të thellë politike, ekonomike dhe sociale. Informacionet e Sigurimit të Shtetit për organizimet e Sindikatave të Pavarura u shtrinë përgjatë gjithë muajve të parë të vitit 1991 dhe kulmuan me grevën e përgjithshme të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura, (organizate e regjistruar në shkurt të vitit 1991), veprimtaria e së cilës ishte vendimtare për zhvillimet demokratike në Shqipëri. Pas zgjedhjeve të 31 marsit 1991 ku fitoi PPSH dhe vrasjeve të 2 prillit në Shkodër, në të gjithë vendin, forca më e madhe demonstruese ishin sindikatat të cilat u organizuan me greva duke paralizuar prodhimin në vend dhe që shkuan deri në greva urie. Lëvizja kulmoi në fund të majit dhe - me presionin e madh që sollën grevat e urisë që 49 minatorëve të pellgut qymyrguror të Tiranës nga 25 maji deri në 6 qershor - përfundoi me dorëheqjen e qeverisë, krijimin e një qeverie tranzicioni dhe përgatitje për zgjedhje të parakohshme (1992).

BASHKIMI I SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË

GREVA E PËRGJITHSHME

PERMBAJTJE #1


Informacione të Sigurimit të Shtetit lidhur me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura

Dosja përmban informacione të zhvillimeve në Tiranë, që nisin nga data 4.1.1991 deri në 10.7.1991. Informacionet lidhen me lëvizjet qytetare në qytete të ndryshme të vendit, sidomos lëvizjeve sindikale të cilat u konkretizuan me greva, pezullime të procesit mësimor në shkolla të mesme dhe universitete, pezullime të punës së punëtorëve nëpër ndërmarrje, si dhe ngjarje të tjera që vijnë në vazhdim: organizimin e zgjedhjeve të 31 marsit, ngjarjet e prillit, reagimin e studentëve të Shkollës së Bashkuar ndaj rrëzimit të përmendores, kërkesat për dorëheqje të presidentit, kandidatët politikë për zgjedhje, etj. Gjithashtu ka informacione për të gjitha ngjarjet e vitit 1991, grevat, zgjedhjet e 31 marsit, vrasjen e 4 demonstruesve në Shkodër më 2.4.1991, vijimin e demonstrimeve, greva e përgjithshme e majit, reagime nga përfaqësues të ambasadave, partisë demokratike etj. Viti 1991 ka qene një vit i ngjeshur me ngjarje dhe përfshirje të gjithë popullsisë në ndryshim. Lëvizja sindikale, e themeluar qysh në janar të vitit 1991, luajti një rol të rëndësishëm sepse përfshiu një numër të madh punonjësish në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe në ndërmarrjet më të rëndësishme të vendit. Organizimi i punonjësve në sindikata dhe veprime të organizuara ishin forca më e madhe që shënjoi lëvizjen demokratike në Shqipëri. Veprimtaria e saj shihet e përfshirë në ngjarjet politike të vitit 1991 dhe të aktorëve të tjerë, si studentë, parti politike, diplomatë të huaj, etj.

MEDIA #1

Për disa të dhëna rreth zhvillimit të ngjarjeve ditëve të fundit në Tiranë

MEDIA FAQE #1



631

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PUNËVE TË BRENDSHME
NR. 615

SEKRET
ekzemplar Nr.1.
106/18
20.2.91 Tiranë, 20.2.1991

9/9
19-7-91

L E N D A: Për disa komentet të ditës

MINISTRIS PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORISE PARE
T I R A N Ë


Nga të dhënat e fundit që disponojmë rezulton se janë zhvilluar këto komente ku synohet të kryhen disa veprime kundërvënëse e në mbrojtje të kërkesës së studentëve.

Bp."Riviera" na informon se duke asistuar në konferencën e sindikatave të pavarura që u zhvillua më dt.19.2.1991 në orën 17.00 ku merrnin pjesë përfaqësues nga të gjitha ndërmarrjet e Tiranës,midis problemeve që u trajtuan disa persona bodhën parrulla si "Poshtë themeluesi i Partisë", ndërsa,ndërsa një pjesmarrës u shpreh:nesër në orën 7.30 në Tiranë do të bëhet një demonstratë masive ku do të përfshihen të gjitha punonjësit e Tiranës për të shkuar në shesh.in "Demokracia" për tu solidarizuar me studentët që janë duke vazhduar grevën e urisë dhe prej këtej do të shkojmë përpara KQ të PPSH për të demonstruar.Për këtë qysh sot kemi derguar përfaqësues në të gjitha ndërmarrjet e Tiranës dhe u kemi bërë thirrje punonjësve që nesër më dt.20.2.1991 të ndërpresin punën dhe të marrin pjesë në këtë demonstratë. Një person tjetër që tha se është përfaqësues i Fabrikës së qumështit deklaroi:sot unë u takova me [illegible] dhe mëshaqës të tjerë të Partisë Demokratike dhe rama dakort që nesër të mos shpërndahet qumështi në Tiranë në mënyrë që të ndjehet deri edhe nga kopshtet dhe yerdhet e fëmijëve.Fëmijët le të bane lëng orizi asnjëherë sic jemi rritur edhe neve.Më pas disautoi një

ARSH


Për disa të dhëna rreth zhvillimit të ngjarjeve ditëve të fundit në Tiranë

MEDIA FAQE #2



Për disa të dhëna rreth zhvillimit të ngjarjeve ditëve të fundit në Tiranë

MEDIA FAQE #3



Për disa të dhëna rreth zhvillimit të ngjarjeve ditëve të fundit në Tiranë

INFORMACION

Për disa të dhëna rreth zhvillimit të ngjarjeve ditëve të fundit në Tiranë

FONDI	4
DOSJA	nr. 147
VITI	1991
	220
	04.01.1991-10.07.1991
STRUKTURA	MInistria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Punëve të Brendshme


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Nr. 621 Prot.
Tiranë, më 20.2 1991

Sekret
Ekz. Nr. 1

Lënda : Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë.

MINISTRIT PUNËVE TË BRENDSHME
SHEFIT KABINETIT
TIRANË

Në përgjigje të thirrjes së bërë nga sindikatat e pamvarura sot më dt.20.2.1991 kanë ndërprerë punën në përkrahje e solidaritet me studentët grevistë disa ndërmarrje ekonomike(pjesërisht dhe plotësisht)dhe kanë shkuar në grevën"Studenti" puntorë të ndërmarrjeve ekonomike e konkretisht:


1.NGA RAJONI NR.1
-Kombinati i Motortraktorëve "E.Hoxha"
-Ndërmarrja e Porcelanit
-Ndërmarrja Komunale Elektrike
-Ndërmarrja e ndërtimit të Minierave
-Ndërmarrja Artistike "Migjeni"
-Kombinati Poligrafik
-Uzina Gjeologjike
-Minostudjo "SH. e Re"
-Ndërmarrja e lesh-punuesve

RAJONI NR.2
-Kombinati i Tekstileve(pjesërisht)
-Fabrika e Qelqit - plotësisht
-Uzina Elektromekanike - pjesërisht.

AIDSSH

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë

MEDIA FAQE #2



61)

2.

-Uzina"Enver"(plotësisht)
-Parku i Udhtarëve (plotësisht)
-Oficina e Automjeteve të komunikacionit(plotësisht)
-Parku i mallrave (plotësisht)
-Ndërmarrja e punimit të veshjeve (plotësisht)
-Shtypshkronja ("Mihal Duri",(plotësisht)

NGA RAJONI NR.3:
-Uzina elektromekanike (plotësisht)
-Uzina abrazivit (plotësisht)
-Uzina "Dinamo" (plotësisht)
-Ndërmarrja Kimike (plotësisht)
-Uzina Dejti (plotësisht)
-Kombinati i mishit(plotësisht)
-Kombinati i qumështit(pjesërisht)
-Ndërmarrja elektrike (pjesërisht)
-Ndërmarrja Hekllsit (pjesërisht)
-Uzina "Partizani" (plotësisht)
-Uzina "Tirana" (plotësisht)
-Uzina e PTT (plotësisht)
-Uzina e veglave bujqësore (pjesërisht)
-Kombinati "J.Pashko", pjesërisht


NGA RAJONI NR.4
-Miniera e Vallasit(pjesërisht)

Deri tani nuk kanë marrë pjesë dhe nuk janë solidarizuar me studentët ndërmarrjet:
-Kombinati "M.Asme"
-Fabrika e Bukës

AIDSSH

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë

MEDIA FAQE #3



62)

3.

-Fabrika e Miellit
-Kombinati Ushqimor "A.Kelmendi"

I PUNËVE TË BRENDSHME
LAHEDIN BARDHI

AIDSSH

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë

INFORMACION

Mbi ndërprerjen e punës në disa ndërmarrje ekonomike në përkrahje të studentëve grevistë

FONDI	4
DOSJA	nr. 147
DATA E KRIJIMIT	20.02.1991
BURIMI	AIDSSH
STRUKTURA	Drejtoria e Punëve të Brendshme
	1991

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.